



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2889/prot

/2

Tiranë më 24. 2 .2022

VENDIM

Nr. 4 datë 21. 08 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKT RAPORTIT TË AUDITIMIT REALIZUAR
PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS TË UT“**

Në mbështetje të neneve 3 pika 3/c, 47, 49 e në vijim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 8, 14, e në vijim të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 12 “Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”, bazuar në planin vjetor 2021, për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të UT, miratuar me Vendimin nr.42 datë 20.10.2020, të Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Projekt Raportit të auditimit me objekt “*Auditim i përputhshmërisë dhe financiar*” të aktivitetit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, për periudhën 01.10.2018 deri më 31.12.2020, realizuar në zbatim të programit të auditimit nr.prot. 2989/1, datë 24.11.2021 “Për angazhimin e auditimit për Fakultetin e Shkencave të natyrës të Universitetit të Tiranës”,
- 2- Ky Projekt Raportit i përcillet zyrtarisht Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës për njohje dhe paraqitje observacionesh.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

